



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNAE KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA - OPŠTINA KUNA
www.komurKi-kline.org



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 39 (1,2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Neni 52 Komuna Klinë shpall:

Konkurs

Ngritje (avancim) në detyrë

Të drejtë për aplikim në këtë procedure kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të një kategorie më të ulët të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.

Titulli i pozitës së punës	Udhëheqës i sektorit të buxhetit
Klasa e pozitës	Drejtues i Ulët
Koeficienti/Paga	7.22
Nr. i kërkuar	1
Data e njoftimit	18/10/2023
Afati për aplikim	02/11/2023 - 09/11/2023
Institucioni	Komuna Klinë
Departamenti	Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim
Divizioni	
Vendi i punës	Klinë
Nr. i Referencës	RN00012662
Kodi	RPC0006128

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Bënë përgatitjen e propozim-buxhetit dhe kërkesën për ndarje buxhetore të organizatës përkatëse buxhetore;
- Siguron që të gjitha transaksionet të regjistrohen në regjistrin e kontabilitetit të thesarit;



3. Mbikëqyrë të gjitha aspekteve, lidhur me raportimet buxhetor nga ana e organizatës buxhetore;
4. Përgatitë raportin financiar dhe të buxhetit;
5. I raporton udhëheqësit, hartimin e raporteve financiare lidhur me menaxhimin e financave;
6. Mban llogari të plota dhe të sakta të të gjitha transaksioneve financiare në SIMFK;
7. Siguron që të plotësohen të gjitha obligimet e organizatës buxhetor, duke përfshirë këtu pagesën me kohë të të gjitha faturave dhe zbatimin e vendimeve të gjykatave;
8. Siguron që të jenë të vendosura sistemet informative dhe procedurat për të monitoruar secilin proces të shpenzimeve (nga iniciimi deri te pagesa e faturave) dhe koordinimi i kalimit të urdhrave për zotimin e pagës dhe dokumentet tjera nga zyrtarët autorizues, te zyra e prokurimit, certifikimi e deri te departamenti i Thesarit (në rastet kur kërkohet);
9. Siguron që nën-alokimi i ndarjes buxhetore të jetë në dispozicion të programet individuale dhe subnjësive brenda komunës, sipas ndarjes së buxhetit të aprovuar nga Kuvendi;
10. Ruajn dokumentet që kanë të bëjnë me të gjitha transaksionet në pajtim me rregullat financiare etj;
11. Harton dhe dorëzon buxhetin e propozuar të organizatës buxhetore dhe kërkesat për ndarje buxhetore etj;
12. Kryen dhe punë tjera sipas ligjit dhe kërkesës së Kryetarit po edhe të drejtorit, të cilave edhe ju përgjigjet.

2. Kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e posaçme për pozitën e lirë

- Nëpunësi të ketë të paktën tre (3) vjet punë në pozitën e një kategorie më të ulët. Në rastin e procedurës për ngritjen në detyrë në një pozitë të kategorisë të ulët drejtuese, periudha e punës provuese llogaritet si kohë përvojës në punë
- Nëpunësi të mos jetë ndëshkuar me masën disiplinore të parashikuar nga nënparagrafi 1.3 i neni 47 të Ligjit, që nuk është shuar ende
- Nëpunësi të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet individuale në punë, gjatë dy (2) viteve të fundit përpara konkurrimit për ngritje në detyrë
- Në rastin e vlerësimit të rezultateve individuale 'shumë mirë' apo 'shkelqyeshëm' për dy vitet e fundit, nëpunësi mund të aplikojë për ngritje në detyrë edhe nëse ka vetëm dy (2) vite punë në kategorinë më të ulët.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve në fushën e ekonomisë me specializim financa apo kontabilitet.

Përvoja e punës e kërkuar: Se paku tri (3) vite përvojë pune profesionale.

4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri të gjera e të thella të politikave, legjisllacionit, procedurave sipas veprimtarisë që mbulon divizionin;
- Aftësi organizative dhe drejtuese për të menaxhuar njësi organizative;
- Aftësi për t'iu përshtatur prioritetëve dhe kërkesave, afateve kohore përmes aftësive analitike dhe zgjidhjes së problemeve;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie besimi me eprorin dhe stafin që e menaxhon;



- Aftësi për të motivuar stafin dhe për të menaxhuar me sukses një sërë projektsh të divizionit/departamentit.

5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për ngritje në detyrë do të shpallet më së largu deri më datën 16/11/2023, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen

- Njohuri dhe përvojë në fushën e menaxhimit të buxhetit dhe financave;
- Shkathtësi të lartë në menaxhim, organizim, caktim të objektivave dhe planifikim;
- Njohuri të mira për mbikëqyrje efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit;
- Shkathtësi të nivelit të lartë në komunikim dhe negocimit;
- Fleksibilitet ndaj organizimit dhe mbikëqyrjes së punës, përfshirë zgjidhjen e problemeve;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internet)

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Interviste

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

10. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:



Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

